

Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003 e 16 dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

Gazeta Zyrtare L 001 , 04/01/2003 fq. 0001 - 0025

Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1/2003e 16 dhjetorit 2002mbi zbatimin e rregullave mbi konkurrencën të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 83 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh mendimin e Parlamentit Europian [2],

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Europian Ekonomik dhe Social [3],

Duke pasur parasysh që:

1. Me qëllim për të themeluar një sistem, i cili siguron që konkurrenca në tregun e përbashkët të mos shtrembërohet, nenet 81 dhe 82 të traktatit duhet të zbatohen në mënyrë efektive dhe të njëtrajtshme brenda Komunitetit. Rregullorja e Këshillit nr. 17 e 6 shkurtit 1962, Rregullorja e Parë e cila mbi zbatimin e neneve 81 dhe 82 [4] të traktatit [5], ka lejuar zhvillimin e një politike konkurrence të Komunitetit, e cila ka ndihmuar në përhapjen e kulturës së konkurrencës brenda Komunitetit. Megjithatë, mbi bazën e përvojës së grumbulluar, kjo rregullore duhet të zëvendësohet tani nga legjislacioni i hartuar për t'u ballafaquar me sfidat e një tregu të integruar dhe një zgjerim të ardhshëm të Komunitetit.
2. Në veçanti, është e nevojshme të rimendohen rregullimet ligjore mbi zbatimin e përjashtimit nga ndalimi i marrëveshjeve, të cilat kufizojnë konkurrencën, të përcaktuara në nenin 81 pika 3 të traktatit. Sipas nenit 83 pika 2 gërma b të traktatit, në lidhje me këtë duhet të merret parasysh nevoja për të siguruar një mbikëqyrje efektive nga njëra anë, dhe për të thjeshtëzuar sa më shumë që është e mundur kontrollin administrativ nga ana tjetër.
3. Skema e centralizuar e përcaktuar nga Rregullorja nr. 17 nuk siguron më ekuilibrin ndërmjet këtyre dy objektivave. Ajo vështirëson zbatimin e rregullave Komunitare të konkurrencës nga gjykatat dhe autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare, dhe sistemi i njoftimeve që ai përfshin, e parandalon Komisionin që të përqendrojë forcat e tij në frenimin e shkeljeve më serioze. Gjithashtu ajo sjell si pasojë shpenzime të konsiderueshme për ndërmarrjet.
4. Sistemi aktual duhet gjithashtu të zëvendësohet me një sistem përjashtimi drejtpërdrejt të zbatueshëm, në të cilin autoritetet e konkurrencës dhe gjykatat e Shteteve Anëtare të kenë të drejtë për të zbatuar jo vetëm nenin 81 pika 1 dhe nenin 82 të traktatit, të cilët janë të zbatueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë, si pasojë e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Europiane, por edhe nenin 81 pika 3 të traktatit.
5. Me qëllim që të sigurohet zbatimi efektiv i rregullave të konkurrencës së Komunitetit, dhe në të njëjtën kohë të respektohen të drejtat themelore të mbrojtjes, kjo rregullore duhet të rregullojë barrën e provës sipas neneve 81 dhe 82 të traktatit. Pala ose autoriteti, i cili pretendon shkeljen e neneve 81 pika 1 dhe

82 të traktatit, ka barrën e të provuarit të ekzistencës së një shkeljeje të tillë ndaj standardeve ligjore të kërkuara. Ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve që pretendon të drejtën e mbrojtjes ndaj një vendimi mbi shkeljen e rregullave duhet të tregojë, në përputhje me standardet ligjore të kërkuara, se kushtet për të zbatuar këtë mbrojtje janë plotësuar. Kjo rregullore nuk ndikon as rregullat kombëtare mbi barrën e provës dhe, as detyrimet e autoriteteve të konkurrencës dhe gjykatave të Shteteve Anëtare të përcaktojnë faktet përkatëse të një çështjeje, në rast se këto rregulla dhe detyrime janë në pajtim me parimet e përgjithshme të së drejtës Komunitare.

6. Me qëllim që të sigurojnë se rregullat e konkurrencës të Komunitetit zbatohen në mënyrë efektive, autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare duhet të lidhen më ngushtë me zbatimin e tyre. Prandaj ato duhet të autorizohen të zbatojnë ligjin Komunitar.
7. Gjykatat kombëtare luajnë një rol kryesor në zbatimin e rregullave Komunitare të konkurrencës. Kur ato vendosin mbi mosmarrëveshjet mes personave privatë, ato mbrojnë të drejtat subjektive sipas ligjit Komunitar, për shembull, duke caktuar një dëmshpërblim për viktimat e shkeljeve. Në këtë rast, roli i gjykatave kombëtare plotëson rolin e autoriteteve të konkurrencës të Shteteve Anëtare. Prandaj ato duhet të lejohen të zbatojnë në tërësi nenet 81 dhe 82 të traktatit.
8. Me qëllim që të sigurohet zbatimi efektiv i rregullave të konkurrencës së Komunitetit dhe funksionimi i duhur i mekanizmave të bashkëpunimit, që përmbliken në këtë rregullore, është e nevojshme të detyrohen autoritetet e konkurrencës dhe gjykatat e Shteteve Anëtare të zbatojnë po ashtu edhe nenet 81 dhe 82 të traktatit, kur ata zbatojnë ligjin kombëtar të konkurrencës mbi marrëveshjet dhe praktikatat që mund të ndikojnë tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare. Me qëllim që të krijohet një nivel fushe loje për marrëveshjet, vendimet nga shoqatat e ndërmarrjeve dhe praktikatat bashkërenduese brenda tregut të brendshëm, është gjithashtu e nevojshme të përcaktohen në mbështetje të nenit 83 pika 2 gërma e të traktatit, marrëdhënie ndërmjet ligjeve kombëtare dhe ligjit të konkurrencës së Komunitetit. Në përgjithësi, është e nevojshme të sigurohet që zbatimi i ligjit kombëtar të konkurrencës për marrëveshjet, vendimet ose praktikatat bashkërenduese brenda kuptimit të nenit 81 pika 1 të traktatit, mund të mos çojë në ndalimin e marrëveshjeve të tilla, vendimeve dhe praktikave bashkërenduese nëse ato nuk janë gjithashtu të ndaluara sipas ligjit të konkurrencës së Komunitetit. Nacionet e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave bashkërenduese janë koncepte autonome të ligjit të konkurrencës së Komunitetit, duke mbuluar koordinimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg siç interpretohet nga gjykatat e Komunitetit. Shtetet Anëtare sipas kësaj rregulloreje nuk duhet të pengohen nga miratimi dhe zbatimi në territoret e tyre të ligjeve konkurrencte të rrepta, të cilët ndalojnë ose vendosin sanksione mbi sjelljen e lidhur të njëanshme nga një ndërmarrje. Këto ligje më të rrepta kombëtare mund të përfshijnë dispozita të cilat ndalojnë ose vendosin sanksione mbi sjelljen abuzive kundrejt ndërmarrjeve të varura ekonomikisht. Për më tepër, kjo rregullore nuk zbatohet për ligjet kombëtare të cilat vendosin sanksione kriminale mbi personat fizikë me përjashtim të shtrirjes që këto sanksione janë mjetet me anën e të cilëve rregullat e konkurrencës të zbatuara te ndërmarrjet janë zbatuar.
9. Nenet 81 dhe 82 të traktatit kanë si qëllim të tyre mbrojtjen e konkurrencës në treg. Kjo rregullore, e cila është miratuar për zbatimin e këtyre dispozitave të traktatit, nuk ndalon Shtetet Anëtare nga zbatimi në territorin e tyre të legjislacionit kombëtar, i cili mbron të tjera interesa legjitime, duke siguruar që një legjislacion i tillë është i krahasueshëm me parime të përgjithshme të dispozitave të tjera të ligjit të Komunitetit. Për sa kohë që këto legjislacione ndjekin kryesisht një qëllim të ndryshëm nga ai i mbrojtjes së konkurrencës në treg, autoritetet e konkurrencës dhe gjykatat e Shteteve Anëtare mund të zbatojnë legjislacione të tilla në territoret e tyre. Mbi këtë bazë, Shtetet Anëtare sipas kësaj rregulloreje mund të zbatojnë në territoret kombëtare legjislacione që ndalojnë ose vendosin sanksione mbi aktet e praktikave të tregtisë së pandershme, qofshin ato të njëanshme ose kontraktuale. Legjislacione të tilla ndjekin një qëllim specifik, të pavarur nga efektet aktuale ose të prezumuara të akteve të tilla mbi konkurrencën në treg. Ky është veçanërisht rasti i legjislacionit, i cili i ndalon ndërmarrjet nga

imponimi mbi partnerët e tyre tregtarë, për të fituar ose duke u përpjekur për të fituar ato terma dhe kushte që janë të pajustificuara, të pabarabarta ose pa asnjë konsideratë.

10. Rregullore të tilla si 19/65/KEE [6], (KEE) nr. 2821/71 [7], (KEE) nr. 3976/87 [8], (KEE) nr. 1534/91 [9]) ose (KEE) nr. 479/92 [10] autorizojnë Komisionin të zbatojë nenin 81 pika 3 të traktatit me anë të rregulloreve për kategori të caktuara marrëveshjesh, vendimesh të bashkimeve të ndërmarrjeve dhe praktikave bashkërenduese. Në fushat e përcaktuara nga rregullore të tilla, Komisioni ka miratuar dhe mund të vazhdojë të miratojë të ashtuquajturat rregullore përjashtuese "në bllok", në të cilat ai deklaron se neni 81 pika 1 i traktatit nuk është i zbatueshëm për kategori marrëveshjesh, vendimesh dhe praktikash bashkërenduese. Nëse marrëveshjet, vendimet dhe praktikat bashkërenduese mbi të cilat zbatohen këto rregullore përjashtuese "në bllok", kanë efekte që janë të papajtueshme me nenin 81 pika 3 të traktatit, Komisioni dhe autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare duhet të kenë kompetenca të tërheqin në raste të veçanta, përfitimet e rregullores përjashtuese "në bllok".
11. Për të siguruar që dispozitat e traktatit janë të zbatueshme, Komisioni duhet të jetë në gjendje t'i adresojë vendimet për ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve, me qëllim që të çojë në një fund shkeljet e neneve 81 dhe 82 të traktatit. Duke siguruar që është një interes legjitim duke vepruar kështu, Komisioni duhet të jetë gjithashtu në gjendje të miratojë vendime, të cilat gjejnë kur një shkelje është kryer në të shkuarën edhe pse nuk është vendosur një gjobë. Kjo rregullore duhet gjithashtu të vendosë një rregull juridik të qartë mbi të drejtën e Komisionit për të miratuar vendime që urdhërojnë masa të përkohshme, të cilat janë njohur nga Gjykata e Drejtësisë.
12. Kjo rregullore duhet të përcaktojë një rregull juridik të qartë mbi të drejtën e Komisionit, për të vendosur çdo masë rregulluese, si në sjellje ashtu edhe strukturore, e cila është e domosdoshme për t'i dhënë fund shkeljes, duke pasur parasysh parimin e përpjestueshmërisë. Masat rregulluese strukturore duhet të vendosen vetëm aty ku ose nuk ka masa rregulluese sjelljeje me efektivitet të njëjtë, ose aty ku çdo masë rregulluese sjelljeje me efektivitet të njëjtë do të ishte më e rëndë për ndërmarrjen përkatëse sesa masat rregulluese strukturore. Ndryshimet në strukturën e një ndërmarrjeje, ashtu siç ekzistonte para kryerjes së shkeljes, do të jenë në përpjesëtim vetëm kur ka një rrezik thelbësor për një shkelje të zgjatur ose të përsëritur që është pasojë e vetë strukturës së ndërmarrjes.
13. Kur, gjatë punimeve, të cilat mund të çojnë në një marrëveshje ose praktikë që është e ndaluar, ndërmarrjet paraqesin angazhimet e Komisionit në mënyrë që të shprehin problemet e tij, Komisioni duhet të jetë në gjendje të miratojë vendimet të cilat i bëjnë këto angazhime detyruese për ndërmarrjet përkatëse. Vendimet e ndërmarrja duhet të shprehin që nuk ka më fusha veprimi sipas Komisionit pa arritur në përfundimin nëse ka pasur ose ka akoma një shkelje. Vendimet e ndërmarrja nuk cenojnë fuqinë e autoriteteve të konkurrencës dhe gjykatave të Shteteve Anëtare për të bërë një përcaktim të tillë dhe të vendosin në lidhje me këtë rast. Vendimet e ndërmarrja nuk janë të përshtatshme në rastet kur Komisioni vendos të caktojë një gjobë.
14. Me përjashtim të rasteve kur e kërkon interesi publik i Komunitetit, mundet që gjithashtu të jetë e përshtatshme për Komisionin që të miratojë një vendim të natyrës deklarative duke zbuluar që ndalimi i neneve 81 dhe 82 të traktatit nuk zbatohet me një shikim sqarues të ligjit, dhe, duke siguruar që zbatimet e qëndrueshme nëpërmjet Komunitetit, në veçanti në lidhje me tipet e reja të marrëveshjeve ose praktikave që nuk janë vendosur në çështjen ligjore ekzistuese dhe praktikave administrative.
15. Komisioni dhe autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare duhet të formojnë bashkë një rrjet të autoriteteve publike duke zbatuar rregullat e konkurrencës së Komunitetit në bashkëpunim të ngushtë. Për këtë qëllim, është e nevojshme të vendosen rregulla për informim dhe këshillim. Më tepër modalitete për bashkëpunimin brenda rrjetit do të vendosen dhe rishikohen nga Komisioni, në bashkëpunim të ngushtë me Shtetet Anëtare.

16. Pavarësisht ndonjë dispozite kombëtare të kundërt, shkëmbimi i informacioneve dhe përdorimi i këtyre informacioneve duhet të lejohet ndërmjet anëtarëve të rrjetit edhe atëherë kur informacioni është konfidencial. Ky informacion mund të përdoret për zbatimin e nenit 81 dhe 82 të traktatit, ashtu si dhe për zbatimin paralel të ligjit kombëtar të konkurrencës, duke parashikuar që zbatimi i mëvonshëm lidhet me të njëjtën çështje dhe nuk të çon në një përfundim tjetër. Kur informacioni i shkëmbyer është përdorur nga autoriteti marrës për të vendosur sanksione mbi ndërmarrjet, duhet të jetë mbi një limit tjetër për përdorimin e informacionit, sesa detyrimi për të përdorur atë për qëllimet për të cilin është mbledhur, duke marrë parasysh faktin se sanksionet e vendosura mbi ndërmarrjet janë të një lloji në të gjitha sistemet. Të drejtat e mbrojtjes që i takojnë ndërmarrjeve në sistemet e ndryshme mund të konsiderohen mjaftueshëm ekuivalente. Megjithatë, për sa i përket personave fizikë, ata mund t'i nënshtrohen llojeve të ndryshme thelbësore të sanksioneve ndërmjet sistemeve të ndryshme. Atëherë kur është rasti, është e nevojshme të sigurohet që informacioni mund të përdoret vetëm nëse është mbledhur në një mënyrë, e cila respekton të njëjtin nivel mbrojtjeje të personit fizik siç është parashikuar nga rregullat kombëtare të autoritetit pritës.
17. Nëse rregullat e konkurrencës do të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme, dhe në të njëjtën kohë rrjeti do të menaxhohet në mënyrën më të mirë të mundshme, është thelbësore të kihet parasysh rregulli që autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare janë automatikisht të çliruar nga kompetenca e tyre nëse Komisioni fillon punimet e tij. Kur një autoritet konkurrence i një Shteti Anëtar aktualisht po vepron mbi një çështje, dhe Komisioni ka si qëllim të fillojë punime, duhet të përpiqet ta bëjë këtë sa më shpejt të jetë e mundur. Para se të fillojë punimet, Komisioni duhet të këshillohet me autoritetin kombëtar përkatës.
18. Për t'u siguruar që çështjet janë trajtuar nga autoritetet më të përshtatshme brenda rrjetit, duhet të formulohet një parashikim i përgjithshëm, i cili i lejon autoritetit të konkurrencës të pezullojë ose mbyllë një çështje, me arsyetimin se një tjetër autoritet po merret me të ose është marrë me të, duke pasur si objektiv që çdo çështje duhet të merret nga një autoritet i vetëm. Ky parashikim nuk duhet të ndalojë Komisionin nga refuzimi i një ankese për mungesë të interesit të Komunitetit, për aq sa çështja gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë ka pranuar se mund të bëhet, edhe pse asnjë autoritet tjetër nuk ka trajtuar interesin për t'u marrë me çështjen.
19. Komiteti Këshillimor mbi Praktikën Kufizuese dhe Pozitat Dominuese i themeluar nga Rregullorja nr. 17 ka funksionuar në një mënyrë shumë të pëlqyeshme dhe do të vendoset shumë mirë në sistemin e ri të zbatimit të decentralizuar. Është e nevojshme megjithatë, të ndërtohet sipas rregullave të vendosura nga Rregullorja nr.17, duke përmirësuar efektivitetin e marrëveshjeve organizative. Në këtë përfundim, do të ishte e përshtatshme të lejohej dorëzimi i opinioneve përmes procedurës së shkruar. Komiteti Këshillimor duhet gjithashtu të jetë i aftë të veprojë si një forum për diskutimin e çështjeve që po trajtohen nga autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare, për të ndihmuar zbatimin e vazhdueshëm të rregullave të konkurrencës së Komunitetit.
20. Komiteti Këshillimor duhet të përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve të konkurrencës të Shteteve Anëtare. Për takimet në të cilat janë diskutuar çështjet e përgjithshme, Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të caktojnë një përfaqësues shtesë. Kjo bëhet pa cenuar anëtarët e komitetit që do të asistohen nga ekspertë të tjerë të Shteteve Anëtare.
21. Në mënyrë të vazhdueshme, zbatimi i rregullave të konkurrencës gjithashtu kërkon që rregullimet të bëhen për bashkëpunimin midis gjykatave të Shteteve Anëtare dhe Komisionit. Kjo është e përshtatshme për të gjitha gjykatat e Shteteve Anëtare që zbatojnë nenet 81 dhe 82 të traktatit, kur zbatojnë këto rregulla në procese gjyqësore ndërmjet palëve private, duke vepruar si forcë publike ose si gjykatë rishikuese. Në veçanti gjykatat kombëtare duhet të jenë në gjendje të pyesin Komisionin për informacione dhe për opinionin e tij për sa i përket pikave lidhur me zbatimin e ligjit të konkurrencës së Komunitetit. Komisioni dhe autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare duhet gjithashtu të jenë në gjendje të nënshkruajnë vërejtje të shkruara ose gojore për gjykatat që zbatojnë nenet 81 dhe 82 të

traktatit. Këto vërejtje duhet të nënshkruhen brenda strukturës së rregullave kombëtare procedurale dhe praktikave që përfshijnë mbrojtjen e të drejtave të palëve. Si pasojë duhet të ndërmerren hapat për të siguruar që Komisioni dhe autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare të mbahen të mirëinformuara për punimet para gjykatave kombëtare.

22. Me qëllim për të siguruar përputhshmërinë me parimet ligjore dhe zbatimin e njëtrajtshëm të rregullave të konkurrencës së Komunitetit në një sistem paralel pushtetesh, duhet të shmangen vendimet konfliktuale. Ndaj është e nevojshme të sqarohen, në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë, efektet e vendimeve të Komisionit dhe punimet për gjykatat dhe autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare. Vendimet e ndërmarrë që janë adoptuar nga Komisioni nuk ndikojnë në fuqinë e gjykatave, dhe autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare të zbatojnë nenet 81 dhe 82 të traktatit.
23. Komisioni duhet të jetë i autorizuar në të gjithë Komunitetin të kërkojë të marrë informacion të tillë aq sa është i nevojshëm për të zbuluar ndonjë marrëveshje, vendim ose praktikë referuese të ndaluar nga neni 81 i traktatit ose ndonjë abuzim të pozitës dominuese të ndaluar nga neni 82 i traktatit. Kur pajtohen me një vendim të Komisionit, ndërmarrjet nuk mund të detyrohen të pranojnë që kanë kryer një shkelje, por ato janë të detyruara në çdo rast t'i përgjigjen pyetjeve faktike dhe për të siguruar dokumente, edhe nëse ky informacion mund të përdoret për të vërtetuar ekzistencën e një shkeljeje kundër tyre ose kundër një ndërmarrjeje tjetër.
24. Komisioni duhet gjithashtu të jetë i autorizuar për të ndërmarrë inspektime të tilla që janë të nevojshme për të zbuluar ndonjë marrëveshje, vendim ose praktikë referuese të ndaluar nga neni 81 i traktatit ose ndonjë abuzim të një pozite dominuese të ndaluar nga neni 82 i traktatit. Autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare duhet të bashkëpunojnë aktivisht në ushtrimin e këtyre fuqive.
25. Zbulimi i shkeljeve të rregullave të konkurrencës po rritet dhe po bëhet më i vështirë, dhe me qëllim që të mbrohet konkurrenca efektive duhet të shtohen fuqitë e Komisionit për hetimet. Në veçanti Komisioni duhet të jetë i autorizuar veçanërisht për intervistimin e çdo personi, i cili mund të ketë informacion të vlefshëm dhe të regjistrojë qëndrimet e mbajtura. Gjatë një inspektimi, nëpunësit e autorizuar nga Komisioni duhet të jenë të autorizuar që të vendosin vulën për periudhën e kohës së nevojshme për inspektim. Normalisht dokumentet duhet të vulosen brenda 72 orësh. Zyrtarët e autorizuar nga Komisioni duhet gjithashtu të jenë të autorizuar të pyesin për çdo informacion përkatës, për subjektet dhe qëllimet e inspektimit.
26. Eksperienca ka treguar se ka raste kur regjistrat e biznesit janë mbajtur në shtëpi, nga drejtuesit ose njerëz të tjerë që punojnë në ndërmarrje. Me qëllim ruajtjen e efektivitetit të inspektimeve, zyrtarët dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni duhet të jenë i autorizuar të hyjnë në çdo godinë ku mund të mbahen regjistrat e biznesit, përfshirë dhe shtëpitë private. Megjithatë, ky ushtrim i kësaj fuqie të fundit duhet t'i nënshtrohet autorizimit të autoritetit gjyqësor.
27. Pa cenuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë, është e nevojshme të shprehet qëllimi i kontrollit që autoriteti kombëtar juridik mund të mbajë kur autorizon, ashtu siç është parashikuar nga ligji kombëtar duke përfshirë si një masë paraprake asistencën nga ligji themelues i autoriteteve, me qëllim që të kapërcejë kundërshti të mundshme mbi ndërmarrjen palë ose për ekzekutimin e vendimeve për të ndërmarrë inspektime në godina jotregtare. Rezulton nga praktika gjyqësore se në veçanti autoriteti ligjor kombëtar mund të pyesë Komisionin për informacion të mëtejshëm, i cili nevojitet të marrë kontrollin e tij dhe në mungesë të të cilit mund të refuzojë autorizimin. Praktika gjyqësore gjithashtu konfirmon kompetencat e gjykatave kombëtare për të kontrolluar zbatimin e rregullave kombëtare që drejtojnë zbatimin e masave detyruese.
28. Me qëllim që të ndihmojë autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare për zbatimin e neneve 81 dhe 82 të traktatit në mënyrë efektive, është e përshtatshme t'i mundësohet atyre të asistojnë njëra tjetrën, duke ndërmarrë inspektimet dhe masa të tjera për fakte përfundimtare.

29. Në përputhje me nenet 81 dhe 82 të traktatit dhe plotësimin e detyrimeve të vendosura mbi ndërmarrjet dhe bashkimet e ndërmarrjeve, sipas kësaj rregulloreje duhet të forcohet kuptimi i gjobave dhe pagesave periodike sanksionuese. Si përfundim, duhet të vendosen gjithashtu nivele të përshtatshme të gjobave për shkeljet e rregullave procedurale.
30. Me qëllim që të sigurohen përmirësime efektive të gjobave të vendosura mbi shoqatat e ndërmarrjeve për shkelje që ato kanë kryer, është e nevojshme të paraqiten kushtet mbi të cilat Komisioni mund të kërkojë pagesat e gjobave për anëtarët e shoqatës kur shoqata nuk ka aftësi paguese. Në këtë rast, Komisioni duhet të ketë parasysh madhësinë relative të ndërmarrjeve që i përkasin shoqatës dhe në veçanti situatën e ndërmarrjeve të vogla ose të mesme. Pagesa e gjobave nga një ose disa anëtarë të një shoqate është pa cenuar rregullat e ligjit kombëtar që sigurohen për përmirësim të shumës së paguar nga anëtarë të tjerë të shoqatës.
31. Rregullat për periudhën e kufizimit të vendosjes së gjobave dhe pagesave periodike sanksionuese ishin paraqitur në Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 2988/74, [11], të cilës gjithashtu i përkasin gjobitjet në fushën e transportit. Në një sistem pushtetesh paralele, aktet, të cilat mund të ndërpresin një periudhë kufizuese, duhet të përfshijnë hapat procedurale të marra në mënyrë të pavarur nga autoriteti i konkurrencës të Shtetit Anëtar. Për të sqaruar strukturën ligjore, Rregullorja (KEE) nr. 2988/74 , duhet të amendohet për të parandaluar zbatimin e tij për çështje të mbuluara nga kjo rregullore dhe kjo rregullore duhet të përfshijë dispozitat e periudhave të kufizimit.
32. Ndërmarrjeve përkatëse duhet t'i jepet e drejta të dëgjohen nga Komisioni, palët e treta interesi i të cilëve mund të ndikohet nga një vendim, duhet t'i jepet mundësia e nënshkrimit të observacioneve para kohe dhe vendimet e marra duhet të botohen gjerësisht. Ndërsa sigurohet e drejta e mbrojtjes së ndërmarrjes që i përkasin në veçanti, e drejta e aksesit të dokumentit është thelbësore që sekretet e biznesit të jenë të mbrojtura. Konfidencialiteti i informacionit të shkëmbyer në rrjet duhet të mbrohet në të njëjtën mënyrë.
33. Derisa gjithë vendimet e marra nga Komisioni sipas kësaj rregulloreje i nënshtrohen rishikimit nga Gjykata e Drejtësisë në përputhje me traktatin, Gjykata e Drejtësisë duhet të ketë dhënë në përputhje me nenin 229 të tij, juridiksion të palimituar në lidhje me vendimet me të cilat Komisioni vendos gjoba ose pagesa sanksionuese periodike.
34. Parimet e paraqitura në nenet 81 dhe 82 të traktatit, ashtu siç janë zbatuar nga Rregullorja nr. 17 kanë dhënë një rol qendror ndaj enteve të Komunitetit. Ky rol qendror duhet të mbahet, duke bashkëpunuar Shtetet Anëtare më ngushtë për zbatimin e rregullave të konkurrencës së Komunitetit. Në përputhje me parimet e shtimit dhe përpjesëtimin ashtu siç janë vendosur në nenin 5 të traktatit, kjo rregullore nuk shkon më tej sesa është e nevojshme për të realizuar objektivën e saj, e cila është për t'i lejuar rregullat e konkurrencës së Komunitetit që të zbatohen në mënyrë efektive.
35. Për të arritur një zbatim të vërtetë të ligjit të konkurrencës së Komunitetit, Shtetet Anëtare duhet të emërojnë dhe autorizojnë autoritetet për të zbatuar nenet 81 dhe 82 të traktatit si detyrime publike. Ato duhet të jenë në gjendje të emërojnë autoritete administrative ashtu si dhe juridike për të kryer funksione të ndryshme të akorduara nga autoritetet e konkurrencës në këtë rregullore. Kjo rregullore njeh variacionin e gjerë i cili ekziston në sistemet e zbatimit publik të Shteteve Anëtare. Efektet e nenit 11 pika 6 të kësaj rregulloreje duhet të zbatohen për të gjitha autoritetet e konkurrencës. Si një përjashtim për këtë rregull të përgjithshëm, kur një autoritet prokuror sjell një rast para një autoriteti ligjor të veçantë, neni 11 pika 6 duhet të zbatohet ndaj autoritetit prokuror duke iu nënshtruar kushteve të nenit 35 pika 4 të kësaj rregulloreje. Kur këto kushte nuk janë përmbushur, rregulli i përgjithshëm duhet të zbatohet. Në çdo rast, neni 11 pika 6 nuk duhet të zbatohet për gjykatat për sa kohë ato veprojnë si gjykata rishikuese.

36. Kur praktika gjyqësore e ka bërë të qartë që rregullat e konkurrencës zbatohen për transportin, ai sektor duhet t'i nënshtrohet dispozitave procedurale të kësaj rregulloreje. Rregullorja e Këshillit nr. 141, dt. 26 nëntor 1962 që përjashton transportin nga zbatimi i Rregullores nr. 17 [12] duhet megjithatë të shfuqizohet dhe Rregullorja (KEE) nr. 1017/68 [13], (KEE) 4056/86 [14] dhe (KEE) nr. 3975/87 [15] duhet të ndryshohet për të fshirë dispozitat procedurale specifike që ato përmbajnë.
37. Kjo rregullore respekton të drejtat themelore dhe mbikëqyr parimet e njohura në veçanti nga Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European. Në vijim, kjo rregullore duhet të interpretohet dhe zbatohet duke respektuar këto të drejta dhe parime.
38. Siguria ligjore për ndërmarrjet që funksionojnë sipas rregullave të konkurrencës së Komunitetit kontribuon për promovimin e risive dhe investimeve. Kur praktikat ngrihen për të vërtetuar pasigurinë sepse ato paraqitin një lloj të ri ose pyetje të pazgjdhura për zbatimin e këtyre rregullave, ndërmarrjet individuale mund të shprehin dëshirë të kërkojnë udhëzime jozyrtare nga Komisioni. Kjo rregullore nuk çënon aftësinë e Komisionit për të lëshuar këto udhëzime jozyrtare.

KA MIRATUAR KETE DIREKTIVË:

KAPITULLI I PARIMET

Neni 1

Zbatimi i neneve 81 dhe 82 të traktatit

1. Marrëveshjet, vendimet dhe praktikat bashkërenduese të shënuara sipas nenit 81 pika 1 të traktatit, të cilat nuk përmbushin kushtet e nenit 81 pika 3 të traktatit, duhet të ndalohen jo përpara vendimit që është kërkuar për këtë efekt.
2. Marrëveshjet, vendimet dhe praktikat bashkërenduese të shënuara sipas nenit 81 pika 1 të traktatit, që përmbushin kushtet e nenit 81 pika 3 të traktatit, duhet të ndalohen jo përpara vendimit që është kërkuar për këtë efekt
3. Abuzimi me pozitën dominuese, të referuar në nenin 82 të traktatit, duhet të ndalohet jo përpara vendimit që është kërkuar për këtë qëllim.

Neni 2

Barra e provës

Në secilën nga punimet kombëtare ose të Komunitetit për zbatimin e neneve 81 dhe 82 të traktatit, barra e provës për shkeljen e nenit 81 pika 1 ose nenit 82 të traktatit duhet t'i përkasë palës ose autoritetit që pretendon se shkelet. Ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve që pretendojnë përfitim nga neni 81 pika 3 i traktatit mban barrën e të provuarit që kushtet e atij paragrafi janë përmbushur.

Neni 3

Lidhja ndërmjet neneve 81 dhe 82 të traktatit dhe ligjeve kombëtare të konkurrencës

1. Nëse autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare ose gjykatat kombëtare zbatojnë ligjin kombëtar të konkurrencës për marrëveshjet, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve ose praktikat bashkërenduese brenda kuptimit të nenit 81 pika 1 të traktatit që mund të ndikojë tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare brenda kuptimit të asaj dispozite, ato duhet gjithashtu të zbatojnë nenin 81 për këto marrëveshje, vendime ose praktika bashkërenduese. Nëse autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare ose gjykatat kombëtare miratojnë ligjin kombëtar të konkurrencës për çdo abuzim të ndaluar nga neni 82 i traktatit, ato duhet gjithashtu të zbatojnë nenin 82 të traktatit.

2. Zbatimi i ligjit kombëtar të konkurrencës mund të mos çojë në ndalimin e marrëveshjeve, vendimeve të shoqatave të ndërmarrjeve ose praktikave bashkërenduese, të cilat mund të ndikojnë tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare, por të cilat nuk kufizojnë konkurrencën brenda kuptimit të nenit 81 pika 1 të traktatit, ose i cili përmbush kushtet e nenit 81 pika 3 të traktatit, ose të cilat janë mbuluar nga rregullorja për zbatimin e nenit 81 pika 3 të traktatit. Shtetet Anëtare nuk duhet që sipas kësaj marrëveshjeje të pengohen nga miratimi dhe zbatimi në territoret e tyre të ligjeve të rrepta kombëtare, të cilat ndalojnë ose sanksionojnë udhëheqje të njëanshme të ndërmarrja nga ndërmarrja.
3. Pa cenuar parimet e përgjithshme dhe dispozitave të tjera të ligjit të Komunitetit, paragrafët 1 dhe 2 nuk zbatohen kur autoritetet e konkurrencës dhe gjykatat e Shteteve Anëtare zbatojnë ligje të kontrollit të përqendrimeve, ose që pengojnë zbatimin e parashikimeve të ligjit kombëtar, që kryesisht ndjekin një objektiv të ndryshëm nga ai i ndjekur nga nenet 81 dhe 82 të traktatit.

KAPITULLI 2 KOMPETENCAT

Neni 4

Kompetencat e komisionit

Për qëllimin e zbatimit të neneve 81 dhe 82 të traktatit, Komisioni duhet të ketë kompetencat e parashikuara sipas kësaj rregullore.

Neni 5

Kompetencat e autoriteteve të konkurrencës të Shteteve Anëtare

Autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare duhet të kenë kompetencën për zbatimin e neneve 81 dhe 82 të traktatit në raste individuale. Për këtë qëllim, duke vepruar me nismën e tyre ose në bazë të një ankese, ata mund të marrin vendimet e mëposhtme:

- të kërkojnë që një shkelje të përfundojë;
- urdhërimin e masave të përkohshme;
- pranimin e angazhimeve;
- vendosjen e gjobave, pagesave periodike ndëshkimore ose çdo ndëshkim tjetër të parashikuar në ligjin kombëtar të tyre.

Kur mbi bazat e informacionit që ata disponojnë, kushtet e ndalimit nuk janë ndeshur, ata gjithashtu mund të vendosin që nuk ka vend për veprim në pjesën e tyre.

Neni 6

Kompetencat e gjykatave kombëtare

Gjykatat kombëtare duhet të kenë kompetencën të zbatojnë nenet 81 dhe 82 të traktatit.

KAPITULLI III VENDIMET E KOMISIONIT

Neni 7

Konstatimidhe përfundimi i shkeljes

1. Kur Komisioni duke vepruar mbi një ankesë ose me nismën e vet, zbulon që ka një shkelje të neneve 81 dhe 82 të traktatit, ai mundet që me vendim t'i kërkojë ndërmarrjes ose shoqatave të ndërmarrjeve përkatëse që të përfundojnë këtë shkelje. Për këtë qëllim, mund të vendosë për to çdo rregullim sjelljeje ose strukturor të cilat janë në përpjestim me shkeljen e kryer dhe domosdoshmërisht ta përfundojnë

shkeljen me efektivitet. Rregullimet strukturore mundet të vendosen vetëm kur nuk ka rregullim sjelljeje efektive të barabartë, ose kur çdo rregullim sjelljeje efektiv i barabartë do të ishte më i rëndë për ndërmarrjen përkatëse sesa rregullimet strukturore. Në qoftë se Komisioni ka një interes legjitim të veprorë kështu, mundet gjithashtu të zbulojë që një shkelje është kryer në të shkuarën.

2. Ata që janë të autorizuar të paraqesin një ankesë për qëllimet e paragrafit 1 janë personat fizikë ose juridikë, të cilët mund të tregojnë një interes legjitim si dhe Shtetet Anëtare.

Neni 8

Masat e përkohshme

1. Në rastet e emergjencës, për shkak të rrezikut të dëmeve të rënda dhe të pariparueshme për konkurrencën, Komisioni, duke vepruar në bazë të nismës së vet mundet që me vendim, mbi bazën e gjetjeve ”*prima facie*” për shkeljen, të urdhërojë masa të përkohshme.
2. Një vendim sipas paragrafit 1 duhet të zbatohet për një periudhë të caktuar kohe dhe mund të përsëritet për aq sa është e nevojshme dhe e përshtatshme.

Neni 9

Angazhimet

1. Atëherë kur Komisioni ka ndërmend të miratojë një vendim duke kërkuar që një shkelje të përfundojë, dhe që ndërmarrja përkatëse të ofrojë angazhime për të takuar shqetësimet për ato sipas Komisionit në vlerësimet e tij paraprake, Komisioni mundet që me vendim t'i bëjë këto angazhime detyruese për ndërmarrjen. Një vendim i tillë mund të miratohet për një periudhë të caktuar dhe duhet të përfshijë që nuk ka më tepër hapësira për të vepruar nga Komisioni.
2. Komisioni mundet që sipas një kërkesë ose me nismën e vet të rihapi punimet:
 - a) kur ka pasur një material që ndryshon ndonjë nga faktet mbi të cilat vendimi është bazuar;
 - b) kur ndërmarrja përkatëse vepron në kundërshtim me angazhimet e saj; ose
 - c) kur vendimi është bazuar mbi informacion të paplotë, të pa rregullt ose mashtrues të siguruara nga palët.

Neni 10

Konstatime të moszbatimit

Kur interesi i publikut të Komunitetit, lidhur me zbatimin e neneve 81 dhe 82 të traktatit, kërkon që Komisioni duke vepruar me nismën e tij, mundet që me vendim të konstatojë se neni 81 i traktatit nuk është i zbatueshëm për një marrëveshje, një vendim nga një shoqatë e ndërmarrjeve ose një praktikë të bashkërenduar, ose sepse kushtet e nenit 81 pika 1 të traktatit nuk janë përmbushur ose sepse kushtet e nenit 81 pika 3 të traktatit janë përmbushur.

Komisioni mundet gjithashtu të bëjë këtë konstatim në referencë të nenit 82 të traktatit.

KAPITULLI IV BASHKËPUNIMI

Neni 11

Bashkëpunimi ndërmjet Komisionit dhe autoriteteve të konkurrencës të Shteteve Anëtare

1. Komisioni dhe autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare duhet të zbatojnë rregullat e konkurrencës në bashkëpunim të ngushtë.

2. Komisioni duhet të transmetojë tek autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare kopje të dokumenteve më të rëndësishme që ka mbledhur me një vështrim për zbatimin e neneve 7, 8, 9 10 dhe nenit 29 pika 1. Me kërkesën e autoritetit të konkurrencës të një Shteti Anëtar, Komisioni duhet të sigurojë një kopje të dokumenteve të tjera ekzistuese të domosdoshme për vlerësimin e çështjes.
3. Autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare duhet, që kur veprojnë sipas nenit 81 ose nenit 82 të traktatit, të informojnë Komisionin me shkrim paraprakisht ose pa vonesë pas fillimit të një mase investiguese formale. Ky informacion mundet gjithashtu të jetë i vlefshëm për autoritetet e konkurrencës të Shteteve të tjera Anëtare.
4. Jo më vonë se 30 ditë para miratimit të një vendimi duke kërkuar që një shkelle të përfundojë, duke pranuar angazhime ose duke tërhequr para përfitimit të rregullores përjashtuese në bllok, autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare duhet të informojnë Komisionin. Për këtë efekt, ata duhet të sigurojnë Komisionin me një përmbledhje të rastit, vendimin parashikues ose në mungesë të tij ndonjë dokument tjetër që tregon kursin e propozuar të veprimit. Ky informacion duhet gjithashtu të bëhet i mundur për autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare. Me kërkesën e Komisionit, autoriteti i konkurrencës veprues duhet të bëjë të vlefshme te Komisioni dokumente të tjerë që mban, të cilat janë të nevojshme për vlerësimin e çështjes. Informacioni i ofruar Komisionit mund të bëhet i vlefshëm për autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare. Autoritetet e Konkurrencës kombëtare mundet gjithashtu të shkëmbejnë ndërmjet tyre informacione të nevojshme për vlerësimin e një çështjeje që ata po përballojnë sipas nenit 81 ose nenit 82 të traktatit.
5. Autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare mund të këshillohen me Komisionin mbi çdo rast që përfshin zbatimin e ligjit të Komunitetit.
6. Nisja nga Komisioni i punimeve për miratimin e vendimit sipas kapitullit 3, duhet të shkarkojë autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare nga kompetencat e tyre për zbatimin e neneve 81 dhe 82 të traktatit. Në qoftë se një autoritet konkurrence i një Shteti Anëtar është aktualisht duke vepruar për një çështje, Komisioni duhet vetëm të nisë punimet pas këshillimit me autoritetin e konkurrencës kombëtare.

Neni 12

Shkëmbimi i informacionit

1. Me qëllim zbatimin e neneve 81 dhe 82 të traktatit, Komisioni dhe autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare duhet të kenë kompetencën për t'i siguruar njëri-tjetrit dhe të përdorin si provë çdo çështje fakti ose ligji, përfshirë informacionin konfidencial.
2. Informacioni i shkëmbyer duhet të përdoret vetëm për qëllimet e zbatimit të nenit 81 ose nenit 82 të traktatit dhe në lidhje me çështjensubjekt për të cilën ka mbledhur nga autoriteti transmetues. Megjithatë, kur ligji kombëtar i konkurrencës është zbatuar në të njëjtën çështje dhe paralel me ligjin Komunitar të konkurrencës, dhe nuk çon në përfundime të ndryshme, informacioni i shkëmbyer sipas nenit mundet gjithashtu të përdoret për zbatimin e ligjit kombëtar të konkurrencës.
3. Informacioni i shkëmbyer në mbështetje të paragrafit 1 mundet të përdoret vetëm me qëllim për të vendosur gjoba për personat fizikë kur:
 - Ligji i autoritetit transmetues parashikon sanksione të një shtate të ngjashme në lidhje me një shkelle të neneve 81 ose 82 të traktatit ose në mungesë të tij,
 - Informacioni është grumbulluar në një mënyrë që respekton të njëjtin nivel mbrojtjeje të të drejtave të mbrojtjes së personave fizikë, siç është parashikuar nga rregullat kombëtare të shtetit pritës. Megjithatë, në këtë rast, informacioni i shkëmbyer nuk mund të përdoret nga autoriteti pritës për të vendosur sanksione doganore.

Neni 13

Pezullimi ose pushimi i punimeve

1. Kur autoritetet e konkurrencës të dy ose më shumë Shteteve Anëtare kanë marrë një ankesë ose po veprojnë me nismën e tyre sipas nenit 81 ose 82 të traktatit kundër të njëjtës marrëveshje, vendim të një shoqate ose praktike, fakti që një autoritet po merret me çështjen, duhet të jetë e mjaftueshme për të tjerët që të pezullojnë punimet para tyre ose të refuzojnë ankesën. Komisioni mundet gjithashtu të refuzojë një ankesë me arsyetimin se një autoritet konkurrence i një Shteti Anëtar po merret me çështjen.
2. Kur një autoritet konkurrence i një Shteti Anëtar ose Komisioni ka marrë një ankesë kundër një marrëveshjeje, vendimi të një shoqërie ose praktike, e cila është shqyrtuar tashmë nga një autoritet tjetër konkurrence, mund ta refuzojë atë.

Neni 14

Komiteti Këshillimor

1. Komisioni duhet të këshillohet me një Komitet Këshillimor mbi praktikatat kufizuese dhe pozitive dominuese para marrjes së një vendimi, sipas neneve 7, 8, 9, 10 dhe 23, të paragrafit 2 të nenit 24 pika 2 dhe nenit 29 pika 1.
2. Për diskutim të rasteve individuale, Komiteti Këshillimor përbëhet nga përfaqësuesit e autoriteteve të konkurrencës të Shteteve Anëtare. Për mbledhjet në rrjedhë të të cilave janë diskutuar të tjera çështje nga rastet individuale, mund të emërohet një përfaqësues shtesë nga Shteti Anëtar i rastit, kompetent në fushën e konkurrencës. Përfaqësuesit në pamundësi për të marrë pjesë, mund të zëvendësohen nga të tjerë përfaqësues.
3. Këshillimi mund të zërë vend në rrjedhën e një mbledhjeje të thirrur dhe të kryesuar nga Komisioni, i cili mbahet deri në 14 ditë pas dërgimit të kërkesës, shoqëruar me një përmbledhje të çështjes, një tregues të pjesëve më të rëndësishme dhe një projekt-vendimi fillestar. Në përputhje me vendimet në mbështetje të nenit 8, mbledhja mund të mbahet 7 ditë pas dërgimit të dispozitivit të një projektvendimi. Kur Komisioni dërgon një mendim përmbledhës duke thirrur një mbledhje e cila ka një afat më të shkurtër njoftimi se ato të përcaktuara më lart, kjo mbledhje mund të bëhet në rast se asnjë vend anëtar nuk paraqet vërejtje për këtë. Komiteti Këshillimor shpërndan një mendim me shkrim mbi projektvendimin e Komisionit. Ai mund ta shpërndajë një mendim edhe nëse mungojnë disa anëtarë apo nuk janë të pranishëm. Mbi kërkesën e një ose shumë anëtarëve, qëndrimet e shprehura në mendim duhet të jenë të arsyetuara.
4. Këshillimi mund të bëhet gjithashtu sipas një procedure me shkrim. Gjithsesi, në qoftë se një Shtet Anëtar bën për këtë një kërkesë, Komisioni mund të thërrasë një mbledhje. Në rast të një procedure me shkrim, Komisioni duhet të vendosë një afat, jo më pak se 14 ditë, brenda të cilit Shtetet Anëtare të hartojnë vërejtjet e tyre dhe t'ia përcjellin ato të gjitha Shteteve Anëtare. Kur në vendimet që do të merren procedohet në mbështetje të nenit 8, afati 14 ditor do të zëvendësohet me 7 ditë. Kur Komisioni cakton, për një procedurë me shkrim, një afat më të shkurtër se ky i përmendur më lart, afati i propozuar zbatohet vetëm nëse asnjë Shtet Anëtar nuk paraqet vërejtje.
5. Komisioni merr parasysh maksimalisht mendimin e dhënë nga Komiteti Këshillimor. Ai informon këtë të fundit, mbi mënyrën e mbajtjes parasysh të mendimit të tij.
6. Kur mendimi i Komitetit Këshillimor është dhënë me shkrim, ai i bashkëlidhet projektvendimit. Nëse Komiteti Këshillimor lejon botimin, Komisioni procedon me botimin duke mbajtur parasysh interesat legjitime të ndërmarrjeve në atë që sekretet e tyre të biznesit të mos jenë të hapura për shfrytëzim.
7. Me kërkesë të një autoriteti të konkurrencës të një Shteti Anëtar, Komisioni përfshin në rendin e ditës të Komitetit Këshillimor çështjet që janë trajtuar nga një autoritet konkurrence të një Shteti Anëtar sipas

neneve 81 ose 82 të Traktatit. Komisioni mundet të procedojë gjithashtu me nismën e tij. Në të dy rastet Komisioni informon autoritetin përkatës të konkurrencës.

Një autoritet i një Shteti Anëtar pikërisht mund të paraqesë një kërkesë në lidhje me një çështje të cilën Komisioni ka ndërmend të fillojë punime që të ketë efektet, përshkruar në nenin 11, pika 6.

Komiteti Këshillimor nuk jep mendime në lidhje me çështjet e trajtuara nga autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare. Gjithashtu ai mundet të diskutojë çështjet e përgjithshme të rëndësishme të së drejtës së konkurrencës të Komunitetit.

Neni 15

Bashkëpunimi me gjykatat kombëtare

1. Në punimet për zbatimin e neneve 81 ose 82 të traktatit, gjykatat e Shteteve Anëtare mund t'i kërkojnë Komisionit që t'u komunikojë atyre informacione, të cilat i ka në dispozicion, ose mendimin e tij në lidhje me çështjet që lidhen me zbatimin e rregullave të konkurrencës të Komunitetit.
2. Shtetet Anëtare përcjellin në Komision kopje të të gjitha vendimeve gjyqësore me shkrim të kryera nga gjykatat kombëtare për të vendosur mbi zbatimin e neneve 81 ose 82 të traktatit. Një kopje e tillë duhet të përcillet pa vonesë, pasi vendimi gjyqësor i plotë dhe i shkruar u është njoftuar palëve.
3. Autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtarë, duke vepruar me nismën e tyre mund të paraqesin vërejtjet e shkruara për gjykatat kombëtare të Shtetit të tyre Anëtar, mbi çështjet e lidhura me zbatimin e neneve 81 ose 82 të traktatit. Me autorizimin e gjykatës në fjalë, gjithashtu ato mund të paraqesin edhe vërejtje me gojë. Kur zbatimi aktual i nenit 81 ose nenit 82 të traktatit urdhërohet gjithashtu, Komisioni, duke vepruar me nismën e tij mund të paraqesë vërejtje me shkrim për gjykatat e Shteteve Anëtare. Me autorizimin e gjykatës së çështjesai mund të paraqesë gjithashtu edhe vërejtje me gojë.

Për qëllim të përgatitjes vetëm të vërejtjeve të tyre, autoritetet e konkurrencës dhe Komisioni mund t'i kërkojnë gjykatës përkatëse të Shtetit Anëtar t'i kalojë ose t'i sigurojë atyre transmetimin e të gjithë dokumenteve të nevojshme për vlerësimin e çështjes.

4. Ky nen nuk cenon pushtetet më të gjera të paraqesin vërejtjet para se gjykatat të kenë vendosur mbi autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare sipas legjislacionit të Shtetit të tyre Anëtar.

Neni 16

Zbatimi i njëtrajtshëm i ligjit të konkurrencës së Komunitetit

1. Kur ligji i gjykatave kombëtare mbi marrëveshjet, vendimet ose praktikrat sipas nenit 81 ose nenit 82 të traktatit të cilat janë tashmë subjekt i një vendimi të Komisionit, ato nuk mund të marrin vendime të cilat shkojnë në kundërshtim me vendimin e miratuar nga Komisioni. Ato duhet të evitojnë gjithashtu dhënien e vendimeve të cilët bien në kundërshtim me një vendim të parashikuar nga Komisioni në punimet që ai ka nisur. Për këtë efekt, gjykata kombëtare mund ta vlerësojë në qoftë se është e nevojshme të pezullojë punimet e tij. Ky detyrim nuk cenon të drejtat dhe detyrimet sipas nenit 234 të traktatit.
2. Kur autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare drejtojnë marrëveshjet, vendimet ose praktikrat sipas nenit 81 ose nenit 82 të traktatit, të cilat janë tashmë subjekt i një vendimi të Komisionit, ato nuk mund të marrin vendime që do të shkonin në kundërshtim të vendimit të miratuar nga Komisioni.

KAPITULLI V KOMPETENCATE HETIMIT

Neni 17

Hetimet brenda sektorëve të ekonomisë dhe brenda tipeve të marrëveshjeve tipeve

1. Kur tendenca e tregtisë ndërmjet Shteteve Anëtare, ngurtësia e çmimeve ose rrethana të tjera sugjerojnë që konkurrenca mund të jetë kufizuar ose shtrembëruar në brendësi të tregut të përbashkët, Komisioni mund të çojë hetimin e tij brenda një sektori të veçantë të ekonomisë ose brenda një tipi të veçantë marrëveshjeje nëpër sektorë të ndryshëm. Gjatë të këtij hetimi, Komisioni mund t'u kërkojë ndërmarrjeve ose shoqatave të ndërmarrjeve që kanë lidhje për t'i dhënë informacionin e nevojshëm për t'i dhënë efekt neneve 81 dhe 82 të traktatit dhe mund të kryejë inspektimet e nevojshme për këtë qëllim.

Komisioni pikërisht mund t'u kërkojë ndërmarrjeve ose shoqatave të ndërmarrjeve në fjalë, që t'i komunikojnë atij të gjitha marrëveshjet, vendimet dhe praktikatat bashkërenduese.

Komisioni mund të botojë një raport mbi rezultatet e hetimit të tij brenda sektorëve të veçantë të ekonomisë ose brenda tipeve të veçantë marrëveshjesh në sektorë të ndryshëm dhe pret komentet nga palët e interesuara.

2. Nenet 14, 18, 19, 20, 22, 23 dhe 24 zbatohen *mutatis mutandis* (me ndryshimet përkatëse).

Neni 18

Kërkesat për informacion

1. Për të kryer detyrat e shënuara për atë nga kjo rregullore, Komisioni, sipas një kërkesë të thjeshtë ose sipas një vendimi, mund t'u kërkojë ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve të sigurojnë gjithë informacionin e nevojshëm.

2. Kur ai i dërgon një kërkesë të thjeshtë për informacion një ndërmarrjeje ose një shoqate ndërmarrjesh, Komisioni duhet të tregojë bazën ligjore dhe qëllimin e kërkesës, saktëson çfarë informacioni është kërkuar dhe cakton afatin brenda të cilit informacioni duhet të jetë siguruar dhe dënimet e parashikuara në nenin 23 për dhënien e informacionit të pasaktë ose të rremë.

3. Kur Komisioni u kërkon me vendim ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve të japin informacion, ai duhet të shpallë bazën ligjore dhe qëllimin e kërkesës, saktëson çfarë informacioni është kërkuar dhe afatin në të cilin ai duhet të jetë dhënë. Ai duhet gjithashtu të tregojë dënimet e parashikuara në nenin 23 dhe tregon ose vendos dënimet e parashikuara në nenin 24. Ai, për më tepër, duhet të tregojë të drejtën për ta pasur vendimin të rishikuar nga Gjykata e Drejtësisë.

4. Pronarët e ndërmarrjeve ose përfaqësuesit e tyre dhe në rastin e personave juridikë, kompanitë ose firmat, ose shoqatat të cilat nuk kanë personalitet juridik, personat e autorizuar që t'i përfaqësojnë ato sipas ligjit ose kushtetutës, duhet të japin informacionin e kërkuar në emër të ndërmarrjes ose shoqatës së ndërmarrjeve përkatëse. Avokatët të autorizuar sipas rregullit për të vepruar mund të japin informacionin në emër të klientëve të tyre. Këta të fundit qëndrojnë plotësisht përgjegjës, në qoftë se informacioni i dhënë është i paplotë, i pasaktë ose i rremë.

5. Komisioni duhet të përcjellë pa vonesë një kopje të kërkesës së thjeshtë ose vendimit të autoritetit të konkurrencës të Shtetit Anëtar, në territorin e të cilit është vendosur selia e ndërmarrjes ose shoqatës së ndërmarrjeve dhe në autoritetin e konkurrencës të Shtetit Anëtar, territori i të cilit është prekur.

6. Me kërkesë të Komisionit, qeveritë dhe autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare t'i japin Komisionit gjithë informacionin e nevojshëm për të përmbushur detyrat, të cilat i janë paraqitur atij sipas kësaj rregulloreje.

Neni 19

Kompetenca e mbledhjes së deklaratave

1. Për të përmbushur detyrat të cilat i janë caktuar atij sipas kësaj rregulloreje, Komisioni ka të drejtë për të marrë në pyetje çdo person fizik ose juridik që jep pëlqimin për t'u intervistuar, me qëllim që të mbledhë informacion në lidhje me çështjen nën shqyrtim.

2. Nëse intervista në përputhje me paragrafin 1 zhvillohet në ambientet e një ndërmarrjeje, atëherë Komisioni duhet të informojë autoritetin e konkurrencës të Shtetit Anëtar në territorin e të cilit është zhvilluar intervista. Në qoftë se kërkohet kështu sipas autoritetit të konkurrencës të Shtetit Anëtar, nëpunësit e tij mund të ndihmojnë nëpunësit dhe personat e tjerë shoqërues të autorizuar nga Komisioni për të drejtuar intervistën.

Neni 20

Kompetenca e inspektimit të Komisionit

1. Për të përmbushur detyrat e caktuara atij sipas kësaj rregulloreje, Komisioni mund të udhëheqë gjithë inspektimet e nevojshme të ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve.

2. Nëpunësit dhe persona të tjerë të cilët ata i shoqërojnë, të mandatuar nga Komisioni për të drejtuar një inspektim autorizohen:

- a) të mbikëqyrin gjithë godinat, terrenet dhe mjetet e transportit të ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve;
- b) të kontrollojnë librat dhe gjithë regjistrat që kanë lidhje me biznesin, pavarësisht nga vendi në të cilin ato janë magazinuar;
- c) të marrin ose të pajisen në disa forma të kopjeve ose ekstrakteve nga këto libra ose regjistra;
- d) të vulosin çdo godinë biznesi, libra apo regjistra për periudhën dhe hapësirën e nevojshme për inspektimin;
- e) të kërkojë shpjegime nga gjithë përfaqësuesit ose anëtarët e personelit të ndërmarrjes ose shoqatës së ndërmarrjes për shpjegimet mbi faktet ose dokumentet në lidhje me objektin dhe qëllimin e inspektimit dhe regjistrimin e përgjigjeve.

3. Nëpunësit dhe persona të tjerë që shoqërojnë ata, të mandatuar nga Komisioni për të drejtuar një inspektim, duhet të ushtrojnë pushtetet e tyre bazuar në formulimin e një autorizimi me shkrim, i cili përcakton objektin dhe qëllimin e inspektimit dhe dënimet e parashikuara në nenin 23, në rastin kur paraqitja e librave dhe regjistrave të tjerë në lidhje me biznesin është e paplotë ose kur përgjigjet për pyetjet e bëra sipas paragrafit 2 të nenit në fjalë, janë të pasakta dhe të rreme. Komisioni, në kohën e duhur para inspektimit, njofton autoritetin e konkurrencës të Shtetit Anëtar në territorin e të cilit duhet të drejtohet inspektimi.

4. Ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve janë të detyruara t'i nënshtrohen inspektimeve të urdhëruara nga një vendim i Komisionit. Vendimi duhet të përcaktojë objektin dhe qëllimin e një inspektimi, të fiksojë datën në të cilën ai (inspektimi) fillon dhe të tregojë sanksionet e parashikuara në nenet 23 dhe 24 dhe të drejtën për të pasur vendimet e rishikuara nga Gjykata e Drejtësisë. Komisioni duhet t'i marrë këto vendime pasi është këshilluar me autoritetin e konkurrencës të Shtetit Anëtar mbi territorin e të cilit do të zhvillohet inspektimi.

5. Nëpunësit e autoritetit të konkurrencës të shtetit mbi të cilin do të zhvillohet inspektimi, po kështu dhe punonjësit shoqërues të autorizuar ose të përshkruar si më lart, me kërkesë të këtij autoriteti ose të Komisionit ndihmojnë aktivisht nëpunësit dhe personat e tjerë shoqërues të autorizuar nga Komisioni. Për këtë qëllim ata do të gëzojnë fuqitë e specifikuar në paragrafin 2.

6. Kur nëpunësit ose persona të tjerë që i shoqërojnë ata të autorizuar nga Komisioni konstatojnë që një ndërmarrje e kundërshton një inspektim të urdhëruar në mbështetje të këtij neni, Shteti Anëtar i interesuar u ofron atyre ndihmën e nevojshme, duke kërkuar kur është e nevojshme ndihmën e policisë ose një forcë ekuivalente, për t'u dhënë mundësi atyre të drejtojnë inspektimin.

7. Nëse ndihma e parashikuar në paragrafin 6 kërkon autorizim nga një autoritet gjyqësor sipas rregullave kombëtare, duhet zbatuar ky autorizim. Një autorizim i tillë mund të zbatohet si një masë paraprake.

8. Kur autorizimi është zbatuar siç referohet në paragrafin 7, autoriteti gjyqësor kombëtar duhet të kontrollojë, nëse vendimi i Komisionit është autentik dhe që masat detyruese të parashikuara nuk janë as arbitrare dhe as të tepërta duke pasur parasysh objektin e inspektimit. Në kontrollin e tij të përpjesëtimit me masat detyruese, autoriteti gjyqësor kombëtar mund t'i kërkojë Komisionit, drejtpërdrejtë ose me ndërmjetësimin e autoritetit të konkurrencës të Shtetit Anëtar, për shpjegimet e detajuara, në veçanti mbi motivet që ka Komisioni për të dyshuar shkeljen e neneve 81 dhe 82 të traktatit, si edhe mbi seriozitetin e shkeljes së dyshuar dhe mbi natyrën e përfshirjes së ndërmarrjes përkatëse. Megjithatë, autoriteti gjyqësor kombëtar nuk mund të marrë në konsideratë nevojën për inspektimin, as të kërkojë që ai të figurojë me informacionin në dosjen e Komisionit. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit duhet t'i nënshtrohet rishikimit vetëm nga Gjykata e Drejtësisë.

Neni 21

Inspektimi i godinave të tjera

1. Në qoftë se ekziston një dyshim i arsyeshëm që librat ose regjistra të tjerë të lidhura me biznesin dhe me objektin e inspektimit, i cili mund të ishte i përshtatshëm për të provuar një dhunim të rëndë të nenit 81 ose nenit 82 të traktatit, janë duke u mbajtur në të tjera godina, terrene dhe mjete transporti, duke përfshirë shtëpitë e drejtorëve, menaxherëve, menaxherëve dhe anëtarëve të tjerë të stafit të ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve përkatëse, Komisioni mund të urdhërojë sipas një vendimi të ndërmerret një inspektim brenda këtyre godinave të tjera, terreneve dhe mjeteve të transportit.

2. Vendimi duhet të specifikojë objektin dhe qëllimin e inspektimit, cakton datën në të cilën ai do të fillojë dhe dëshmojë të drejtë për të pasur vendimin të rishikuar nga Gjykata e Drejtësisë. Ai duhet të tregojë në veçanti arsyet që kanë udhëhequr Komisionin të konkludojë që ekziston një dyshim përkrah paragrafit 1. Komisioni duhet të marrë të tilla vendime pasi të jetë këshilluar me autoritetin e konkurrencës të Shtetit Anëtar mbi territorin e të cilit do të zhvillohet inspektimi.

3. Një vendim i miratuar në mbështetje të paragrafit 1, nuk mund të ekzekutohet pa pasur më përpara një autorizim nga autoriteti gjyqësor kombëtar i Shtetit Anëtar përkatës. Autoriteti gjyqësor kombëtar duhet të kontrollojë në qoftë se vendimi i Komisionit është autentik dhe që masat detyruese të parashikuara nuk janë as arbitrare dhe as të tepërta, duke pasur parasysh seriozitetin e shkeljeve të vërejtura, me rëndësinë e provave të kërkuara, me implikimin e ndërmarrjes përkatëse dhe probabilitetin e mundshëm që librat dhe regjistrat që kanë lidhje me objektin e inspektimit të jenë ruajtur në godina për të cilat është kërkuar inspektimi. Autoriteti gjyqësor kombëtar mund t'i kërkojë Komisionit, drejtpërdrejtë ose me ndërmjetësimin e autoritetit të konkurrencës të Shtetit Anëtar, për shpjegime të hollësishme mbi elemente të cilët janë të nevojshme të lejojnë kontrollin e tij të përpjestueshmërisë së masave të parashikuara detyruese.

Megjithatë, autoriteti gjyqësor kombëtar nuk mund të marrë në konsideratë nevojën e inspektimit as të kërkojë informacionet që figurojnë në dosjen e Komisionit. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit do t'i nënshtrohet rishikimit vetëm nga Gjykata e Drejtësisë.

4. Nëpunësit dhe personat e tjerë shoqërues të autorizuar nga Komisioni për të drejtuar një inspektim të urdhëruar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të kenë fuqinë e parashikuar në nenin 20 pika 2 gërmat a, b dhe c. Neni 20 pikat 5 dhe 6 duhet të zbatohen *mutatis mutandis*.

Neni 22

Hetimet nga autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare

1. Autoriteti i konkurrencës i një Shteti Anëtar mund të kryejë në territorin e tij çdo inspektim ose të tjera masa për mbledhjen e fakteve sipas legjisllacionit të tij kombëtar në emër dhe për llogari të autoritetit të konkurrencës së një Shteti tjetër Anëtar me qëllim që të konkludojë nëse ka pasur shkelje të neneve 81 dhe 82 të traktatit. Shkëmbimi dhe përdorimi i informacionit të grumbulluar kryhet në bazë të nenit 12.

2. Me kërkesën e Komisionit, autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare duhet të ndërmarrë inspektimet të cilat Komisioni i konsideron të nevojshme sipas nenit 20 pika 1, ose të cilat ai i ka urdhëruar nëpërmjet një vendimi në mbështetje të nenit 20 pika 4. Nëpunësit e autoriteteve të konkurrencës të Shteteve Anëtare të cilët janë të ngarkuar të kryejnë këto inspektime, po kështu edhe nëpunësit e autorizuar ose të emëruar nga autoritetet, duhet të ushtrojnë fuqitë e tyre në përputhshmëri me ligjin e tyre kombëtar.

Në qoftë se kërkohet nga Komisioni ose nga autoriteti i konkurrencës së Shtetit Anëtar në territorin e të cilit do të kryhet inspektimi, atëherë nëpunësit e Komisionit dhe personat e tjerë që i shoqërojnë me autorizimin e Komisionit mund të ndihmojnë nëpunësit e autoritetit të konkurrencës në fjalë.

KAPITULLI VI SANKSIONET

Neni 23 Gjobat

1. Komisioni mund të marrë vendim mbi vënien e gjobave mbi ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve, deri në 1% të xhiros totale të realizuar në vitin fiskal paraardhës, nëse këto me dashje ose nga pakujdesia:

- a) japin informacion të pasaktë ose që mund të çojë në përfundime të gabuara në përgjigje të kërkesës së bërë në mbështetje të nenit 17 ose 18 pika 2;
- b) në përgjigje të kërkesës së kryer me vendim, miratuar në mbështetje të nenit 17 ose nenit 18 pika 3, paraqet informacion të pasaktë, jo të plotë, ose që mund të çojë në përfundime të gabuara, ose nuk paraqet informacionin e kërkuar brenda afatit të kërkuar;
- c) paraqet regjistra kontabël ose dokumente të tjera në lidhje me aktivitetin e tyre, të paplotë, gjatë inspektimeve të kryera në përputhje me nenin 20, ose kundërshtojnë kryerjen e inspektimit të urdhëruar me vendim, miratuar në mbështetje të nenit 20 pika 4;
- d) në përgjigje të një pyetjeje që u është drejtuar në përputhje me nenin 20 pika 2 gërma e,
 - ato paraqesin një përgjigje të pasaktë ose që mund të çojë në përfundime të gabuara, ose
 - ato nuk korrigjojnë brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni një përgjigje të pasaktë, të paplotë ose që mund të çojë në përfundime të gabuara, të paraqitur nga një anëtar i personelit, ose
 - ato nuk paraqesin ose kundërshtojnë të paraqesin një përgjigje të plotë mbi faktet në lidhje me çështjen dhe qëllimin e inspektimit, të urdhëruar me një vendim të miratuar në mbështetje të nenit 20 pika 4;
- e) vulat e vendosura, në përputhje me nenin 20 pika 2 gërma d, nga nëpunësit ose persona të tjerë që i shoqërojnë me autorizimin e Komisionit, janë thyer.

2. Komisioni me vendim mund të vendosë gjoba mbi ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve nëse këto me dashje ose nga pakujdesia:

- a) shkelin dispozitat e nenit 81 ose 82 të traktatit; ose
- b) nuk i binden një vendimi që urdhëron masa të përkohshme, në përputhje me nenin 8, ose
- c) nuk respektojnë një premtim të bërë të detyrueshëm me vendim në mbështetje të nenit 9.

Për çdo ndërmarrje ose shoqatë ndërmarrjesh që merr pjesë në shkeljen e dispozitave, gjoba nuk duhet të jetë më e madhe se 10% e xhiros totale të vitit fiskal paraardhës.

Kur shkelja e bërë nga një shoqatë lidhet me veprimtaritë e anëtarëve të saj, gjoba nuk mund të kalojë 10% të shumës së xhiros totale të realizuar nga çdo anëtar aktiv në tregun e prekur nga shkelja e shoqatës.

3. Për të përcaktuar masën e gjobës, duhet të merret në konsideratë, rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes.

4. Kur një gjobë është vendosur ndaj një shoqate ndërmarrjesh duke mbajtur në llogari xhiron vjetore të anëtarëve të saj dhe shoqata nuk ka aftësi paguese, ajo është e detyruar t'i kërkojë kontribute anëtarëve të saj për të mbuluar shumën e gjobës.

Kur këto kontribute nuk i janë dhënë shoqatës brenda një afati të përcaktuar nga Komisioni, ky i fundit mund të vendosë pagimin e gjobës drejtpërdrejtë nga gjithë ndërmarrjet ku përfaqësuesit e të cilave janë anëtarë të organeve përkatëse vendimmarrëse të shoqatës.

Pasi Komisioni ka kërkuar pagesën sipas paragrafit të dytë kur është e nevojshme të sigurohet pagesa e plotë e gjobës, Komisioni mund të kërkojë pagesën e bilancit nga secili prej anëtarëve të shoqatës, të cilët kanë qenë aktivë në tregun në të cilin ka ndodhur shkelja.

Megjithatë, sipas nënparagrafit të dytë dhe të tretë Komisioni nuk duhet të kërkojë pagesë nga ndërmarrjet, të cilat tregojnë se nuk kanë zbatuar vendimin e padrejtë të shoqatës dhe po ashtu nuk ishin në dijeni të ekzistencës së tij, dhe janë distancuar në mënyrë të dukshme nga një vendim i tillë, para se Komisioni të fillonte të hetonte për çështjen.

Besueshmëria financiare e çdo ndërmarrjeje në lidhje me pagesën e gjobës nuk duhet të kalojë 10% të xhiros totale të vitit vijues financiar.

5. Vendimet e marra në mbështetje të paragrafëve 1 dhe 2 nuk duhet të kenë karakter penal.

Neni 24

Kamatëvonesat

1. Komisioni, nëpërmjet një vendimi, mund të ndëshkojë ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve deri në masën 5% të xhiros mesatare ditore për çdo ditë të vitit vijues financiar dhe të llogaritur nga data e shënuar në vendim, në mënyrë që t'i detyrojë ata:

- a) t'i japin fund një shkeljeje të nenit 81 ose nenit 82 të traktatit në përputhshmëri me një vendim të marrë në mbështetje të nenit 7;
- b) të pajtohen me një vendim që urdhëron masa provizore në mbështetje të nenit 8;
- c) të pajtohen me një urdhër të bërë të detyrueshëm sipas një vendimi në mbështetje të nenit 9;
- d) të ofrojnë informacion të plotë dhe të saktë i cili është kërkuar sipas vendimit në mbështetje të 17 ose nenit 18 pika 3) ;
- e) t'i nënshtrohen një inspektimi të urdhëruar sipas një vendimi të marrë në mbështetje të nenit 20 pika 4.

2. Kur ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve kanë përmbushur detyrimin të cilin kamatëvonesa ka dashur të zbatohet, Komisioni mund të fiksojë shumën e kamatëvonesës të llogaritur më të ulët se ajo e cila do të dilte nga vendimi fillestar. Neni 23 pika 4 duhet të zbatohet në mënyrë të njëjtë.

KAPITULLI VII

PERIUDHAT E PARASHKRIMIT

Neni 25

Periudhat e parashkrimit për imponimin e dënimeve

1. Kompetencat e dhëna për Komisionin në zbatim të neneve 23 dhe 24, i nënshtrohen periudhave të parashkrimit që vijojnë:

- a) 3 vjet në rastin e shkeljeve të dispozitave në lidhje me kërkesat për informacion ose që kanë lidhje me zhvillimin e inspektimit.
- b) 5 vjet në rastin e të gjitha shkeljeve të tjera.

2. Parashkrimi duhet të llogaritet që nga dita në të cilën është kryer. Gjithsesi, për shkelje të vazhdueshme ose të përsëritura, parashkrimi duhet të fillojë të llogaritet në ditën në të cilën shkelja ndërpritet.

3. Çdo veprim i ndërmarrë nga Komisioni ose nga autoriteti i konkurrencës së një Shteti Anëtar për qëllimin e hetimit ose të punimeve në lidhje me një shkelje, do të ndërpresë periudhën e parashkrimit për imponimin e

gjobave ose kamatëvonesave. Periudha e parashkrimit duhet të jetë ndërprerë me rezultat nga data në të cilën veprimi është njoftuar tek të paktën një ndërmarrje ose shoqatë ndërmarrjesh, të cilat kanë marrë pjesë në shkelje. Aktet të cilat ndërpresin zhvillimin e periudhave duhet të përfshihen si më poshtë:

- a) kërkesat e shkruara për informacion nga Komisioni ose nga autoriteti i konkurrencës së një Shteti Anëtar;
- b) autorizimet me shkrim për të kryer inspektime, të lëshuara për nëpunësit e tij nga Komisioni ose nga autoriteti i konkurrencës së një Shteti Anëtar;
- c) fillimi i punimeve nga Komisioni ose nga autoriteti i konkurrencës së një Shteti Anëtar ;
- d) njoftimi i deklaratës së vërejtjeve nga Komisioni ose nga autoriteti i konkurrencës së një Shteti Anëtar;

4. Ndërprerja e një parashkrimi duhet të zbatohet për të gjitha ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve që kanë marrë pjesë në shkelje.

5. Çdo ndërprerje do të rinovojë afatin e parashkrimit përsëri. Megjithatë, afati i parashkrimit duhet të përfundojë fundmit paktën në ditën në të cilën një afat i barabartë me dyfishin e afatit të parashkrimit ka kaluar pa vendosur Komisioni një gjobë ose një kamatëvonesë. Ky afat duhet të shtrihet nga koha gjatë së cilës parashkrimi është pezulluar në mbështetje të paragrafin 6.

6. Afati i parashkrimit për imponimin e gjobave ose pagesave të kamatëvonesave duhet pezulluar për aq kohë sa vendimi i Komisionit bëhet objekt i një procedure të mbetur pezull para Gjykatës së Drejtësisë.

Neni 26

Parashkrimi në fushën e ekzekutimit të sanksioneve

1. Kompetenca e Komisionit për të ekzekutuar vendimet e marra në mbështetje të neneve 23 dhe 24 i nënshtrohet një afati parashkrimi prej 5 vjetësh.

2. Parashkrimi nis të llogaritet në ditën në të cilën vendimi do të finalizohet.

3. Afati i parashkrimit për ekzekutimin e sanksioneve do të ndërpritet:

- a) nga një njoftim i një vendimi duke ndryshuar shumën fillestare të gjobës ose të kamatëvonesës periodike ose duke refuzuar një kërkesë për ndryshim;
- b) nga çdo veprim i Komisionit ose të një Shteti Anëtar, me kërkesën e Komisionit, i përcaktuar për të detyruar pagesën e gjobës ose pagesën periodike të kamatëvonesës.

4. Çdo ndërprerje do të rinovojë parashkrimin përsëri.

5. Afati i parashkrimit për zbatimin e sanksioneve do të pezullohet për aq kohë sa:

- a) lejohet afati për t'u paguar
- b) ekzekutimi i pagesës është pezulluar në mbështetje të një vendimi të Gjykatës së Drejtësisë.

KAPITULLI VIII

DËGJIMI DHE SEKRETI PROFESIONAL

Neni 27

Dëgjimi i palëve, ankimuesve dhe të tjerëve

1. Para se të merren vendimet e parashikuara në nenet 7, 8, dhe 23, si dhe nenit 24 pika 2, Komisioni i jep ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve, të cilat i nënshtrohen punimeve të drejtuara nga Komisioni, mundësinë që t'u dëgjuar mbi çështjet e ankesës mbajtur nga Komisioni. Komisioni i harton vendimet e tij vetëm mbi ankesat, subjektet e të cilave u përkasin palëve që kanë mundur të bëjnë vlerësimin e vëzhgimeve të tyre. Ankimuesit lidhen ngushtë punimet.

2. Të drejtat e mbrojtjes të palëve të përfshira, do të mbrohen plotësisht në këto punime. Ato kanë të drejtën për t'u njohur me dosjen e Komisionit duke iu nënshtruar interesit legjitim të ndërmarrjeve për mbrojtjen e sekreteve të tyre të brendshme. E drejta e shqyrtimit të dosjes nuk përfshin dokumentet konfidenciale dhe ato të brendshme të Komisionit ose të autoriteteve të konkurrencës të Shteteve Anëtare. Veçanërisht, e drejta e shqyrtimit nuk nënkupton korrespondencën mes Komisionit dhe autoriteteve të konkurrencës të Shteteve Anëtare ose ndërmjet këtyre të fundit, duke përfshirë këtu dokumentet e hartuara në mbështetje të të neneve 11 dhe 14. Asgjë në këtë paragraf nuk e ndalon Komisionin të zbulojë ose të përdorë informacionet e nevojshme për të provuar një shkelje.

3. Nëse Komisioni e konsideron të nevojshme, ai mundet gjithashtu të dëgjojë të tjerë persona fizikë ose juridikë. Nëse personat fizikë ose juridikë justifikohen nga një interes i mjaftueshëm që të dëgjohen, ai duhet t'i japë të drejtë kërkesës së tyre. Autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare mundën gjithashtu t'i kërkojnë Komisionit të dëgjojë persona të tjerë fizikë ose juridikë.

4. Kur Komisioni mendon të miratojë një vendim në mbështetje të nenit 9 ose nenit 10, ai boton një përmbledhje koncize të çështjes dhe të përmbajtjes kryesore të zotimeve ose orientimeve të propozuara. Palët e treta të interesuara mundën të paraqesin vërejtjet e tyre brenda një afati kohor të caktuar nga Komisioni në botimin e tij dhe që nuk mund të jetë më pak se një muaj. Botimi merr parasysh interesin legjitim të ndërmarrjeve në mbrojtjen e sekreteve të tyre të afarizmit.

Neni 28

Sekreti profesional

1. Pa cenuar nenet 12 dhe 15, informacionet e mbledhura në zbatim të neneve 17 dhe 22, do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është kërkuar.

2. Pa cenuar këmbimin dhe përdorimin e informacioneve parashikuar në nenet 11, 12, 14, 15, dhe 27, Komisioni dhe autoritetet e konkurrencës të Shteteve Anëtare, nëpunësit e tyre, inspektorët dhe persona të tjerë punues nën mbikëqyrjen e këtyre autoriteteve, si edhe nëpunësit dhe inspektorët civilë të autoriteteve të tjera të Shteteve Anëtare, nuk bëjnë publik asnjë informacion që ata kanë mbledhur ose këmbyer në mbështetje të rregullores në fjalë dhe i cili, nga natyra e tij, mbulohet nga sekreti profesional. Ky detyrim zbatohet gjithashtu për të gjithë përfaqësuesit dhe ekspertët e Shteteve Anëtare, pjesëmarrëse në mbledhjet e Komitetit Këshillimor në mbështetje të nenit 14.

KAPITULLI IX

RREGULLAT E PËRJASHTIMIT

Neni 29

Marrja individuale

1. Nëse Komisioni, i autorizuar nga Rregullorja e Këshillit, si për shembull Rregulloret 19/65/KEE, (KEE) nr. 2821/71, (KEE) nr. 3976/87, (KEE) nr. 1534/91 ose (KEE) nr. 479/92, për të zbatuar nenin 81 pika 3 të Traktatit, deklaron se neni 81 pika 1 i traktatit i pazbatueshëm për disa kategori marrëveshjes, vendimesh nga shoqëri ndërmarrëse ose praktika bashkërenduese, mund të veprojë me nismën e tij ose në bazë të një ankese, të anulojë përfitimin që lejon kjo Rregullore përjashtuese kur zbulon në çdo rast të veçantë se marrëveshja, vendimi ose praktikat bashkërenduese për të cilat zbatohet kjo Rregullore ka efekte të tilla që janë të papajtueshme me nenin 81 pika 3 të traktatit.

2. Nëse, në një rast të veçantë, marrëveshje, vendime shoqatash ndërmarrjeje ose praktika bashkërenduese, në të cilat zbatohet një rregullore e Komisionit referuar në paragrafin 1, prodhojnë efekte të papajtueshme me nenin 81 pika 3 të traktatit, mbi territorin e një Shteti Anëtar, ose mbi një pjesë të këtij territori, i cili paraqet të gjitha

karakteristikat e një tregu gjeografik të dukshëm, autoriteti i konkurrencës i atij Shteti Anëtar, mund të marrë përfitime në zbatim të rregullores në fjalë në lidhje me këtë territor.

KAPITULLI X DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 30 **Botimi i vendimeve**

1. Komisioni boton vendimet që ai merr në mbështetje të neneve 7, 10, 23 dhe 24.
2. Botimi do të shpallë emrat e palëve dhe përmbajtjen thelbësore të vendimit, duke përfshirë sanksionet e vendosura. Ai duhet të ketë parasysh interesin legjitim të ndërmarrjeve me qëllim mbrojtjen e sekreteve të tyre të biznesit.

Neni 31 **Rishikimi nga Gjykata e Drejtësisë**

1. Gjykata e Drejtësisë do të ketë juridiksion të pakufizuar për rishikimin e vendimeve, përmes të cilave Komisioni ka vendosur gjobë ose kamatëvonesa periodike. Ajo mund të anulojë, zvogëlojë, ose zmadhojë gjobën ose kamatëvonesën periodike.

Neni 32 **Përfshirjet**

Rregullorja në fjalë nuk zbatohet në:

- a) transportet detare ndërkombëtare të tipit “shërbim lundrimi me qira në anije të paparacaktuar” në kuptim të nenit 1 pika 3 gërma a të Rregullores (KEE) nr. 4056/86;
- b) në shërbimet e transportit detar që sigurojnë ekskluzivitetin ndërmjet porteve, vendosur në të njëjtin Shtet Anëtar, sikurse parashikohet në nenin 1 pika 2, të Rregullores nr. 4056/86 (KEE);
- c) me transportin ajror mes aeroporteve të Komunitetit dhe vendeve të treta.

Neni 33 **Dispozitat e zbatimit**

1. Komisioni do të autorizohet për të marrë masa të tilla sikurse të jetë e nevojshme, me qëllim zbatimin e kësaj rregulloreje. Këto masa i përkasin *inter alia*:
 - a) formës, përmbajtjes, të tjera hollësi të ankesave të paraqitura në mbështetje të nenit 7, po kështu dhe procedurën e zbatueshme me riparqitjen e ankesës;
 - b) rregullat praktike të këmbimit të informacionit dhe të këshillimit të parashikuar në nenin 11;
 - c) rregullat praktike të seancave dëgjimore të parashikuara në nenin 27.

2. Përpara miratimit të masave në mbështetje të paragrafit 1, Komisioni do të botojë një projekt të tij, dhe fton të gjithë palët e interesuara të paraqesin komentet e tyre brenda një afati që ai cakton, i cili nuk mund të jetë më pak se një muaj. Përpara botimit të një projektmase dhe përpara miratimit të saj, Komisioni këshillohet me Komitetin Këshillimor mbi Praktikën Kufizuese dhe Pozitat Dominuese.

KAPITULLI XI DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 34 **Dispozita Kalimtare**

1. Kërkesat e paraqitura në Komision në zbatim të nenit 2 të Rregullores nr. 17 dhe njoftimet e bëra në zbatim të neneve 4 dhe 5 të rregullores në fjalë, po kështu dhe kërkesat dhe njoftimet përkatëse bërë në zbatim të Rregulloreve (KEE) nr. 1017/68, (KEE) nr. 4056/86 dhe (KEE) nr. 3975/87, janë të pavlefshme të llogariten me datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

2. Masat procedurës të marra në zbatim të Rregullores nr. 17 dhe të Rregulloreve (KEE) nr. 1017/68, (KEE) nr. 4056/86 dhe (KEE) nr. 3975/87 vazhdojnë të jenë të vlefshme për zbatim të rregullores në fjalë.

Neni 35

Emërimi i autoriteteve të konkurrencës të Shteteve Anëtare

1. Shtetet Anëtare emërojnë autoritetin ose autoritetet e konkurrencës kompetente për të zbatuar nenet 81 dhe 82 të traktatit, në mënyrë të tillë që dispozitat e kësaj rregulloreje të jenë efektivisht të përputhshme. Masat e nevojshme për të autorizuar ato autoritete të zbatojnë këto nene do të merren para 1 majit 2004.

Autoritetet e emëruara mund të përfshijnë gjykatat.

2. Kur zbatimi i së drejtës Komunitare në fushën e konkurrencës i besohet autoriteteve kombëtare, administrative dhe gjyqësore, atëherë Shtetet Anëtare mundën t'u caktojnë kompetenca dhe funksione autoriteteve të ndryshme kombëtare, të cilat janë administrative ose gjyqësore.

3. Fuqitë e nenit 11 pika 6, zbatohen nga autoritetet e emëruara nga Shtetet Anëtare, duke përfshirë gjykata që ushtrojnë funksionet e mbajtura mbi përgatitjen dhe miratimin e tipeve të vendimeve të parashikuara në nenin 5. Fuqitë e nenit 11 pika 6, nuk shtrihet tek gjykatat kur ato veprojnë në cilësinë e instancave ankuese, në lidhje me tipet e vendimeve shënuar në nenin 5.

4. Pavarësisht paragrafit 3, në Shtetet Anëtare ku për miratimin e disa lloje vendimesh të parashikuara në nenin 5, një autoritet konkurrence parashtron një padi tek një autoritet gjyqësor, i shkëputur dhe i ndryshëm nga autoriteti i akuzës, dhe për më tepër që kushtet e njoftuara në këtë paragraf të jenë përmbushur, fuqitë e nenit 11 pika 6, janë të kufizuara për autoritetin e akuzës, i cili duhet të tërheqë kërkesën e tij pranë autoriteteve gjyqësore kur Komisioni hap punimet. Kjo tërheqje duhet t'i japë fund punimeve kombëtare.

Neni 36

Ndryshim i Rregullores (KEE) nr. 1017/68

Rregullorja (KEE) nr. 1017/ 68 ndryshohet si vijon:

1. Neni 2 shfuqizohet

2. Në nenin 3 pika 1 fjalët “Ndalim i përcaktuar në nenin 2” zëvendësohen nga fjalët “Ndalim në nenin 81 pika 1 të traktatit”.

3. Neni 4 ndryshohet si vijon:

a) në paragrafin 1 fjalët “Marrëveshjet, vendimet dhe praktikat bashkërenduese referuar në nenin 2” zëvendësohen nga fjalët “Marrëveshjet, vendimet dhe praktikat bashkërenduese në mbështetje të nenit 81 pika 1 të traktatit”

b) paragrafi 2 është zëvendësuar si më poshtë vijon:

“2. Nëse zbatimi i çdo marrëveshjeje, vendimi ose praktike të përbashkët, trajtuar në paragrafin 1, ka, ne rast specifik, efekte të papajtuashme me kërkesat e nenit 81 pika 3 të traktatit, ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve detyrohen t'u japin fund këtyre efekteve”

4. Nenet nga 5 deri në 29 shfuqizohen, me përjashtim të paragrafit 3 të nenit 13, i cili vazhdon të zbatohet në vendimet e miratuara në mbështetje të nenit 5 të Rregullores (KEE) nr. 1017/68 përpara datës së zbatimit të kësaj rregulloreje, deri në humbjen e fuqisë së këtyre vendimeve.

5. Në nenin 30 pikat 2, 3 dhe 4 janë hequr.

Neni 37
Ndryshim i Rregullores (KEE) nr. 2988/74

Neni në vazhdim është përfshirë në rregulloren (KEE) nr. 2988/74:

‘Neni 7 pika a
Përfshirim

Kjo rregullore nuk zbatohet për masat e marra në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1/2003 të 16 dhjetorit 2002 për zbatimin e rregullave të konkurrencës, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit’ [16].

Neni 38
Ndryshim i Rregullores (KEE) nr. 4056/86

Rregullorja (KEE) nr. 4056/86 ndryshohet si vijon:

1. Neni 7 ndryshohet si vijon:

a) paragrafi 1 është zëvendësuar nga teksti në vazhdim:

“1. Shkelja e një detyrimi.

Kur personat e përfshirë shkelin një detyrim të parashikuar në mbështetje të nenit 5, përjashtim i parashikuar në nenin 3, Komisioni, për t’i dhënë fund shkeljeve dhe nisur nga kushtet e parashikuara në Rregulloren 1/2003 të 16 dhjetorit 2002 për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit [17], mund të miratojë një vendim, i cili ose i ndalon ose i detyron, të kryejnë veprime të caktuara, ose heq të drejtën për të përfituar nga përjashtimet në bllok që ata gëzojnë.

b) paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

i) në pikën (a) fjalët “sipas kushteve të përcaktuara në seksionin II” janë zëvendësuar nga fjalët “sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren (KE) nr. 1/2003”;

ii) fjalia e dytë në nënparagrafin e dytë e pikës c, nën-pika i do të zëvendësohet si vijon:

“Në të njëjtën kohë, ai vendos, në përputhje me nenin 9 të Rregullores së (KE) nr. 1/2003, nëse i pranon angazhimet e ofruara nga ndërmarrjet e përfshira, me qëllim që, inter alia, të sigurojë të drejtën për të hyrë në tregun për shoqëritë joanëtare të konferencës”

2) Neni 8 ndryshohet si vijon:

a) paragrafi 1 është hequr;

b) në paragrafin 2, fjalët “në mbështetje të nenit 10” janë zëvendësuar nga fjalët “në mbështetje të Rregullores (KE) nr. 1/2003”

c) paragrafi 3 është fshirë.

3. Neni 9 ndryshohet si vijon:

a) në paragrafin 1, fjalët “Komiteti Këshillimor i përcaktuar në nenin 15” zëvendësohen me fjalët “Komiteti Këshillimor i përcaktuar në nenin 14 të Rregullores (KE) nr. 1/2003”;

b) paragrafi 2, fjalët “Komiteti Këshillimor i përcaktuar në nenin 15” zëvendësohen me fjalët “Komiteti Këshillimor i përcaktuar në nenin 14 të Rregullores (KE) nr. 1/2003”

4. Nenet nga 10 deri në 25 shfuqizohen, me përjashtim të pikës 3 të nenit 13, i cili vazhdon të zbatohet për vendimet e miratuara në mbështetje të nenit 81 paragrafi 3 të traktatit përpara datës së zbatimit të kësaj rregullore deri në datën e shfuqizimit të këtyre vendimeve.

5. Në nenin 26, fjalët “forma, përmbajtja, dhe të tjera hollësi të ankesave në mbështetje të nenit 10, zbatimet në mbështetje të nenit 12 dhe seancat e parashikuara në nenin 23 pikat 1 dhe 2 janë fshirë.

Neni 39

Ndryshim i Rregullores (KEE) nr. 3975/87

Nenet nga 3 deri në 19 të Rregullores 3975/87 janë shfuqizuar, me përjashtim të nenit 6 pika 3, i cili vazhdon të zbatohet për vendimet e miratuara në mbështetje të nenit 81 pika 3 të traktatit, para datës së zbatimit të kësaj rregulloreje deri në datën e shfuqizimit të këtyre vendimeve.

Neni 40

Rregullimi i Rregulloreve nr. 19/65/KEE nr. 2821/71 dhe (KEE) nr. 1534/91

Neni 7 i Rregullores nr. 19/65/KEE, neni 7 i Rregullores (KEE) nr. 2821/71 dhe neni 7 i Rregullores (KEE) nr. 1534/91 janë shfuqizuar.

Neni 41

Ndryshim i Rregullores (KEE) nr. 3976/87

Rregullorja (KEE) nr. 3976/87 ndryshohet si vijon:

1. Neni 6 zëvendësohet nga teksti në vazhdim:

“Neni 6

Përpara botimit të një projektrregulloreje dhe përpara miratimit të një rregulloreje, Komisioni këshillohet me Komitetin Këshillimor sipas nenit 14 të Rregullores së Këshillit (KE) nr.1/2003 të 16 dhjetorit 2002 për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit [18]”.

2. Neni 7 shfuqizohet.

Neni 42

Ndryshim i Rregullores (KEE) nr. 479/92

Rregullorja (KEE) nr. 479/92 ndryshohet si vijon:

1. Neni 5 zëvendësohet nga teksti në vazhdim:

“Neni 5

Përpara botimit të projektrregullores dhe përpara miratimit të rregullores, Komisioni këshillohet me Komitetin Këshillimor sipas nenit 14 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1/2003 të 16 dhjetorit 2002 për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të traktatit [19]”.

2.Neni 6 shfuqizohet.

Neni 43

Shfuqizimi i Rregulloreve nr. 17 dhe nr. 141

1. Rregullorja nr. 17 shfuqizohet me përjashtim të nenit 8 pika 3, i cili vazhdon të zbatohet për vendimet e miratuara në mbështetje të nenit 81 pika 3 të traktatit, para datës së zbatimit të kësaj rregullore deri në ditën e shfuqizimit të këtyre vendimeve.

2. Rregullorja nr. 141 shfuqizohet.

3. Referencat e rregulloreve të shfuqizuara interpretohen si referenca të kësaj rregulloreje.

Neni 44

Raport mbi zbatimin e rregullores në fjalë

Pesë vjet pas datës së zbatimit të kësaj rregulloreje, Komisioni i raporton Parlamentit European dhe Këshillit mbi funksionimin e kësaj rregulloreje, veçanërisht mbi zbatimin e nenit 11 pika 6 dhe nenit 17.

Mbi bazë të këtij raporti, Komisioni vlerëson nëse është e përshtatshme t'i propozojë Këshillit një rishikim të kësaj rregulloreje.

Neni 45

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e 20-të pas datës së botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Ajo është e zbatueshme duke nisur nga 1 maji 2004.

Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjithë Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel më 16 dhjetor 2002.

Për Këshillin

Presidenti

M. Fischer Boel

(1) GZ C 365 E, 19.12.2000, fq. 284.

(2) GZ C 72 E, 21.3.2002, fq. 305.

(3) GZ C 155, 29.5.2001, fq. 73.

(4) Titulli i Rregullores nr. 17 është përshtatur për të pasur parasysh rinumërimin e neneve të Traktatit të KE-së, në përputhje me nenin 12 të Traktatit të Amsterdimit; referenca fillestare ishte për nenet 85 dhe 86 të traktatit.

(5) GZ 13, 21.02.1962, fq. 204/62. Rregullore e ndryshuar së fundi nga Rregullorja (KE) nr. 1216/1999 (GZ L 148, 15.6.1999, fq. 5).

(6) Rregullorja e Këshillit nr. 19/65/KEE e 2 marsit 1965 mbi zbatimin e nenit 81 pika 3 të traktatit (titujt e rregullores janë përshtatur për të pasur parasysh rinumërimin e neneve të Traktatit të KE-së, në përputhje me nenin 12 të Traktatit të Amsterdimit; referenca fillestare ishte për nenin 85 pika 3 të traktatit) mbi kategori të caktuara të marrëveshjeve dhe praktikave bashkërenduese (GZ 36, 6.3.1965, fq. 533). Rregullorja siç është ndryshuar nga Rregullorja (KE) nr. 1215/1999 (GZ L 148, 15.6.1999, fq. 1).

(7) Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 2821/71 e 20 dhjetorit 1971 mbi zbatimin e nenit 81 pika 3 të traktatit (titujt e rregullores janë përshtatur për të mbajtur parasysh rinumërimin e neneve të Traktatit të KE-së, në përputhje me nenin 12 të Traktatit të Amsterdimit; referenca fillestare ishte tek neni 85 pika 3 të traktatit) mbi kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave bashkërenduese (GZ L 285, 29.12.1971, fq. 46). Rregullore siç është ndryshuar së fundi nga Akti i Pranimi i vitit 1994.

(8) Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 3976/87 e 14 dhjetorit 1987 mbi zbatimin e nenit 81 pika 3 të traktatit (titujt e rregullores janë përshtatur për të mbajtur parasysh rinumërimin e neneve të Traktatit të KE-së, në përputhje me nenin 12 të Traktatit të Amsterdimit; referenca fillestare ishte tek neni 85 pika 3 të traktatit) mbi kategori të caktuara të marrëveshjeve dhe praktikave bashkërenduese në sektorin e transportit ajror (GZ L 374, 31.12.1987, fq. 9). Rregullore siç është ndryshuar së fundi nga Akti i Pranimi i vitit 1994.

(9) Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 1534/91 e 31 marsit 1991 mbi zbatimin e nenit 81 pika 3 të traktatit (titujt e rregullores janë përshtatur për të mbajtur parasysh rinumërimin e neneve të Traktatit të KE-së, në përputhje me nenin 12 të Traktatit të Amsterdimit; referenca fillestare ishte tek neni 85 pika 3, të traktatit) mbi kategori të caktuara të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave bashkërenduese në sektorin e sigurimeve (GZ L 143, 7.6.1991, fq. 1)

(10) Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 479/92 e 25 shkurtit 1992 mbi zbatimin e nenit 81 pika 3 të traktatit (titujt e rregullores janë përshtatur për të mbajtur parasysh rinumërimin e neneve të Traktatit të KE-së, në përputhje me nenin 12 të Traktatit të Amsterdimit; referenca fillestare ishte tek neni 85 pika 3 e traktatit) mbi kategori të caktuara të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave bashkërenduese ndërmjet kompanive të transportit detar të rregullt dhe të programuar të mallrave (Koncerne) (GZ L 55, 29.2.1992, fq. 3). Rregullore e ndryshuar nga Akti i Pranimi i vitit 1994.

(11) Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 2988/74 e 26 nëntorit 1974 në lidhje me afatet e kufizuara në procedura dhe zbatimin e sanksioneve sipas rregullave të Komunitetit Ekonomik European në lidhje me transportin dhe konkurrencën (GZ L 319, 29.11.1974, fq. 1).

- (12) GZ 124, 28.11.1962, fq. 2751/62; Rregullore e ndryshuar së fundi nga Rregullorja nr. 1002/67/KEE (GZ 306, 16.12.1967, fq. 1)
- (13) Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 1017/68 e 19 korrikut 1968 duke zbatuar rregullat e konkurrencës për transportin hekurudhor, rrugor dhe lumor të lundrueshëm, (GZ L 175, 23.7.1968, fq. 1). Rregullore e ndryshuar së fundi nga Akti i Pranimit 1994.
- (14) Rregullore e Këshillit (KEE) nr. 4056/86 e 22 dhjetorit 1986 përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e neneve 81 dhe 82 (titulli i rregullores është përshtatur duke pasur parasysh rinumërimin e neneve të Traktatit të KE-së, në përputhje me nenin 12 të Traktatit të Amsterdimit; referenca origjinale ishte për nenet 85 dhe 86 të traktatit për transportin detar (GZ L 378, 31.12.1986, fq. 4). Rregullore e ndryshuar së fundi nga Akti i Pranimit 1994.
- (15) Rregullore e Këshillit (KEE) nr. 3975/87 e 14 dhjetorit 1987, duke përcaktuar procedurën për zbatimin e rregullave të konkurrencës së ndërmarrjeve në sektorin e transportit ajror (GZ L374, 31.12.1987, fq. 1). Rregullore e ndryshuar së fundi nga Rregullorja (KEE) nr. 2410/92 (GZ L 240, 24.8.1992, fq. 18).
- (16) GZ L 1, 4.1.2003, fq. 1.
- (17) GZ L 1, 4.1.2003, fq. 1.
- (18) GZ L 1, 4.1.2003, fq. 1.
- (19) GZ L 1, 4.1.2003, fq. 1.